

Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

## KONTRATË PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT, ZYRA E PROKURIMIT, të cilën e perfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z. Zizë Bujupaj, Rruga "Fadil Ferati" në njërin anë: DHE

Dhe

"INFINITT" SHPK me NRB 71266419 nga Prishtina të cilën e perfaqëson z. Selvije Krasniqi, në cilësinë e Drejtorit të ndermarrjës nga ana tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

### TITULLI I KONTRATËS

#### FURNIZIMI ME LIBRA DHE LEKTYRA SHKOLLORE

#### LOT 4 FURNIZIMI ME LIBRA DHE LEKTYRA PER SH. F. "ZYMER ZEKA" KALIQAN

|                  |                                       |
|------------------|---------------------------------------|
| Nr. I prokurimit | 633 - 019 - 2175- 1-2-1 c / 210 lot 4 |
| I brendshëm      | 633 - 019 - 025 - 1-2-1 —             |

#### Neni 1

#### Lënda

##### 1.1 FURNIZIMI ME LIBRA DHE LEKTYRA SH.F. "ZYMER ZEKA" KALIQAN lot 4

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 21.06.2019 dhe përfundon me së larti 30 ditë pas furnizimit të plotë të mallit të kërkuar respektivisht me 20.07.2019

1.3 Afati kohor i kryerjes së FURNIZIMEVE nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të Kontratës.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve do të jetë Drejtorati Per Arsim i Komunes se Istogut, respektivisht kërkesa e Drejtoratit ne fjalë.

#### Neni 2

#### Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

## **Neni 3**

### **Çmimi**

**3.1 Çmimi total i kontratës LOT 4 FURNIZIMI ME LIBRA DHE LEKTYRA SH.F. "ZYMER ZEKA" KALIQAN do të jetë 2.000,00 €; Me shkronja "Dymijë/zëro zero euro"**

**3.2** Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 4 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prërë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

## **Neni 4**

### **Pagesat**

**4.1** Pagesa do të bëhet në Euro.

**4.2.** Autoriteti Kontraktues do ta paguaj shumën totale të pagesës pas kryerjes së shërbimeve

**4.3.** Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

## **Neni 5**

### **Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

**5.1** Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

**5.2** Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6**

### **Kualiteti**

**6.1** Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

## **Neni 7 Garancioni**

**7.1** Nuk aplikohet

## **Neni 8**

### **Vonesat në ekzekutim**

**8.1** Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryejë njërin ose të gjitha furnizimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale

të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punimeve, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që të inspektojë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund t'i drejtohet, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik,

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Tribunalin e Përhershëm i Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Kosovës.**

#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin i identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.





E hartuar në gjuhën Shqipe dhe Serbisht në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për: Autoritetin Kontraktues:

“Komuna e Istogut

Për: Operatorin Ekonomik:

SHPK “INFINITT”

|             |   |             |   |
|-------------|---|-------------|---|
| Emri:       | Zizë Bujupaj  | Emri:       | Selviqe Krasniqi  |
| Pozita:     | Zyrtar Përgjegjes i Prokurimit  | Pozita:     | D r e j t o r   |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 2019  | Data:       | 25.06.2019  |
| Vula:       |  | Vula:       |  |

## FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

### Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 633-19-2175-1-2-1

**Titulli i kontratës: FURNIZIMI ME LIBRA DHE LEKTYRA pëe Lloto 1-FURNIZIMI ME LIBRA PER BIBLOTEKEN E QYTETIT, Lloto 2-LEKTYRA SHKOLLORE PER GJIMNAZIN HAXHI ZEKA -ISTOG, Lloto 3-LEKTYRA SHKOLLORE PER SHKOLLEN FILLORE HYSNI ZAJMI NE VRELLE,dhe Lloto 4-LEKTYRA SHKOLLORE PER SHKOLLEN FILLORE ZYMER ZEKA -NE KALIQAN.**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

**4 Lloto 4-LEKTYRA SHKOLLORE PER SHKOLLEN FILLORE ZYMER ZEKA -NE KALIQAN.**

3. Çmimi total i tenderit është:

**128,90 EUR**

Dhe në fjalë [ ]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si

rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

**Informacion në lidhje me nënkontraktorët**

| Emri dhe adresa e nënkontraktorit | Numri fiskal - nënkontraktorë | Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet | Pjesa vlera të nënkontraktohet | Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%) |
|-----------------------------------|-------------------------------|---|--------------------------------|--|
|                                   |                               |   |                                |  |
|                                   |                               |   |                                |  |